

Master Shkencor në “**Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshem (Ekonomia Cirkulare)**”

(120 ECTS, 2 vite akademike, me kohë të plotë)

Profili Profesional (Përshkrimi i Degës)

Programi master në “Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshem” ka për qëllim të përgatisë një profil kërkuesish dhe analistësh politikash që mbi bazën e analizave të problematikave në fushat ekonomike, sociale e mjedisore në mjediset rurale propozon dhe vlerëson politika publike adekuate bazuar në evidencë. Riorganizimin e Ciklit të dytë të studimeve dhe propozimi për programin Master Shkencor në “Ekonomi dhe Politikat e zhvillimit të Qëndrueshem (Ekonomia Cirkulare)” është mëse i nevojshëm për shkak të ndryshimeve dinamike dhe sfidave që po ndodhin dhe pritet të ndodhin në sektorin bujqësisë dhe zhvillimit të qëndrueshem në Shqipëri në perspektivën e integrimi të pritshme europiane. Aktualisht, përfshirja dhe adaptimi ndaj këtyre ndryshimeve dinamike kërkon njohuri të zhvilluara në ekonominë e qëndrueshme dhe cirkulare. Këto ndryshime, evidentojnë domosdoshmërinë e transformimit të njohurive për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemeve të shfrytëzimit e burimeve natyrore por njëkohësisht duke qenë të kujdesshëm për mjedisin. Ky program studimi riorganizohet në përputhje me historikut e programit ekzistues Master i Shkencave në Ekonomi dhe Politikat Agrare dhe i bashkohet objektivit të universitetit për të ofruar diploma duale në Bashkëpunim me Universitetin e Viterbos në Itali me të cilin ne kemi një marrëveshje paraprake. Ne synojmë që të mundësojmë një diplomë e cila të ketë elementët më të mirë të informacionit dhe të mundësojë kërkimin shkencor i ndjekur në mënyrë të përbashkët nga profesorë italianë dhe shqiptarë në kuadër të zhvillimit të kërkesave për një ekonomi sa më të qëndrueshme e shtrirë në nivel kombëtar. Këto dinamika, imponojnë një profil të diplomuarish që i përgjigjen kërkesave aktuale e perspektive, lokale por edhe rajonale e ndërkombëtare të tregut të punës. Nga ana tjetër, hapja e programit mban parasysh edhe strategjinë e ndërkombëtarizimit të programeve të studimit të FEA. Në themel të këtij programi studimesh qëndron nevoja për përgatitjen e specialistëve të rinj të ekonomisë dhe zhvillimit të qëndrueshem që aplikojnë metodologjitë dhe mjetet e duhura për të bërë që bizneset t’u përgjigjen më mirë sfidave që imponon mjedisi në kushtet e qëndrueshmërisë ekonomike dhe asaj mjedisore.

Nisur nga sa më sipër, kurrikula e programit të studimit pasqyron nevojat aktuale dhe perspektive të tregut të punës dhe ndryshimet dinamike të cilat kanë ndodhur dhe pritet të ndodhin në politikat e qëndrueshme në vendin tonë.

Programi i studimit që propozohet është një **program unik** përderisa nuk ofrohet nga asnjë universitet tjetër publik apo privat në vendin tonë.

Modulet kryesore të trajtuara përgjatë studimeve të këtij programi:

Mikroekonomi II, Ekonomiksi i Drejtimit, Ekonomiksi i Zhvillimit të Qëndrueshem, Kërkimi Ekonomik i Zbatuar, Ekonomia Qarkulluese dhe Sistemi Ushqimor.

a. Formim i përgjithshëm

1. Të njohë studentët me pasojat aktuale të ekonomisë lineare në një spektër të gjerë ekonomik, social, mjedisor, mbi pritshmëritë dhe shqetësimet afatgjata, shpërdorimet dhe ndotjen, problemet me inputet, prodhimin industrial, etj.
2. Të ofrojë një paraqitje të plotë teorike mbi kuptimin, konceptet kryesore që plotësojnë kuadrin teorik të ekonominë cirkulare, kostot, alokimin e burimeve dhe politikave, duke ilustruar me fakte nga BE dhe improvizuar sipas rajoneve nga Shqipëria, etj;
3. Të ofrojë njohuri të specializuara dhe bashkëkohore në fushat e ekonomisë dhe politikave të bujqësisë, ushqimit, mjedisit, dhe fusha të tjera të lidhura me to; njohuri rreth zhvillimit të qëndrueshëm; njohuri të thelluara rreth politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural në BE, dhe të implikimeve që ato kanë në kuadrin e integritetit në BE.
4. Njohuri mbi proceset dhe sfidat që karakterizojnë ekonominë e prodhimit dhe modelin e konsumit (take, make, ëaste) nga dekadat e kaluara dhe aktualisht në shek. XXI-të, rritjen, dinamikën demografike dhe limitet mjedisore;

b. Formim bazë karakterizues

1. Të nxisë diskutimet kritiko – interaktive të bazuara në njohuri të reja e shumëdisiplinore në çështje që shpjegojnë proceset bashkëkohore ekonomike të prodhimit të industrive në kuadrin e inovacioneve qofshin keto publike ose private si dhe ato, teknologjike, sociale, apo fusha të tjera.
2. Të përshkruajë planifikimin dhe ndërtimin e rrathëve riciklues (sipas teknologjive kryesore aktuale) dhe rolin e tyre në ekonominë cirkulare, rritjen dhe zhvillimin e vetëqëndrueshëm, duke stimuluar zgjidhje (të mundshme) rajonale e vendore.

c. Formim integruar.

1. Të zhvillojë aftësi të specializuara për kryerjen e kërkimit në fushat e ekonomisë të bujqësisë, mjedisit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe asaj të ekonomisë cirkulare.
2. Të zhvillojë kompetenca për të menaxhuar situata komplekse studimi/kërkimi që kërkojnë qasje strategjike në fushat e ekonomisë të bujqësisë, mjedisit, zhvillimit të qëndrueshëm.
3. Të zhvillojë kompetenca për të kontribuar në studime të kërkuara në fushat e ekonomisë të bujqësisë, mjedisit, zhvillimit rural; si dhe në përgatitjen e politikave publike.

Mundësitë për punësim

Sektorët kryesorë të punësimit përfshijnë:

1. Institucionet publike për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural e të qëndrueshëm sic jone: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
2. Qeverisja lokale, Agjencitë e Zhvillimit Rajonal si dhe njësi të tjera lokale. Një treg pune në zgjerim, me zhvillimin e mëtejshëm të decentralizimit, rezulton se janë 61 bashkitë që kërkojnë

njohuri të mëtëjshme për këshillim ekonomik, këshillim bujqësor, këshillim rural si dhe Grupet Lokale të Veprimit, numri i të cilave deri më tani në Shqipëri është 14 (njësi).

Me ngritjen e skemave për mbështetjen e GLV-ve numri i tyre pritet të rritet. .

3. Njësitë e Këshillimit të Biznesit dhe OJF-të: Shumica e njëjësive të këshillimit janë kompani të vogla private, OJQ dhe think tanks.

4. Institucionet financiare: Një nga punëdhënësit më të mëdhenj, është i sektori Financave dhe Bankave. Disa institucione financiare po e rrisin vëmendjen dhe praninë në sektorin agro-shqimor.

5. Donatorë/projekte zhvillimi. Duhet theksuar që të diplomuarit mund të punojnë edhe jashtë vendit, si p.sh. në BE. Duke pasur parasysh perspektivën e qartë të anëtarësimit në BE, shumë të diplomuar mund të punojnë në të ardhme në institucionet e shumta të BE-së.

PROGRAMI MËSIMOR

Viti, Sem	Nr	Modulet	Kredite	
Viti I, Semestri I (1)	1	Mikroekonomi II	5	
	2	Ekonomi Prodhimi	6	
	3	Metodologji Kërkimi	5	
	4	Sistemet e Menaxhimit të Informacionit	6	
	5	Politikat Publike dhe Zhvillimi Rajonal	6	
	6	<i>Italisht</i>	3	
Viti I, Semestri II (2)	1	Ekonomiksi i Drejtimit	5	
	2	Ekonomia dhe Politikat e Mjedisit	6	
	3	Makroekonomi II	6	
	4	Ekonometri	6	
	5	Dizenjimi i Projekteve për Ekonomi të Qëndrueshme	6	
Viti II, Semestri I (3)	1	Ekonomiksi i Zhvillimit të Qendrueshem	6	
	2	Ekonomiksi Publik	5	
	3	Tregti Ndërkombëtare në Zhvillimin e qëndrueshëm	5	
	4	Planifikim Hapësinor	5	
	5	Praktikë Profesionale	9	
Viti II, Semestri II (4)	1	Kërkimi Ekonomik i Zbatuar	4	
	2	Optimizim Ekonomik	6	
	3	Institucionet dhe Organizatat Rurale	4	
	Module me Zgjedhje			
	4	Ekonomia Qarkulluese dhe Sistemi Ushqimor	4	
		Analiza e Politikave Publike te Zhvillimit Rural		
5	Temë Diplome	12		

Totali i Krediteve		1+2+3+4	120
---------------------------	--	----------------	------------